

VENDIM
Nr. 299, datë 11.5.2022

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT, PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
“PORTIT TË INTEGRUAR” NË TRIPORT VLORË, NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE
EKONOMIKË “AGBES CONSTRUCCION” SHPK, “BESTA” SHPK, “PREMIUM
CONSTRUCTION & MAINTENANCE” SHPK, “ITE GRUP” SHPK DHE
“ARKONSTUDIO” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e “Portit të integruar” në Triport Vlorë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Agbes *Construcción*” sh.p.k., “Besta” sh.p.k., “*Premium Construction & Maintenance*” sh.p.k., “ITE Grup” sh.p.k. dhe “ArkonStudio” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama